



Në bazë të dispozitave të nenit 16, pika 16.1 shkronja **h** dhe të dispozitave të nenit 32, pika 32.1, shkronja **e** të Statutit të Komunës së Prishtinës 01. nr. 110-445, të datës 16.4.2008, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 26.11.2008, merr:

V E N D I M
PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E VENDIMIT PËR CAKTIMIN E
KRITEREVE DHE TË PROCEDURËS SË DHËNIES SË QOSHQEVE NË
SHFRYTËZIM

I. DISPOZITAT HYRËSE

Neni 1

Miratohet Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit për caktimin e kriterëve dhe të procedurës së dhënies së qoshqeve në shfrytëzim 01. nr. 353 - 335, të dt. 24.7.2007.

Neni 2

Me këtë Vendim bëhet ndryshimi dhe plotësimi i dispozitave të Vendimit për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të dhënies së qoshqeve në shfrytëzim, në të cilat Komuna e ka të drejtën e pronësisë – sipërfaqet publike.

II. NDRYSHIMET DHE PLOTËSIMET

Neni 3

Neni 4 ndryshohet dhe thuhet:

“Dhënia e qoshqeve në shfrytëzim bëhet në bazë të procedurave të parapara me Ligjin për prokurimin publik, Ligjin për dhënie e koncesioneve dhe sipas kriterëve dhe procedurave të parapara më këtë Vendim”.

Neni 4

Në nenin 7 shtohet:

- 25 për një m², për zonën III të qytetit.

Dhënia e qoshqeve për rastet sociale bëhet pa pagesë.

Neni 5

Neni 9 ndryshon dhe thuhet:

9.1 "Qoshqet jepen sipas procedurës së paraparë me dispozitat e cituara në nenin 4 dhe procedurat e parapara me kontratën e lidhur në mes përfituesit të zgjedhur për punimin e qoshqeve dhe Komunës".

9.2 "Dhënia e qoshqeve në shfrytëzim për rastet e caktuara – rastet sociale, do të bëhet nga Komisioni për dhënie e qoshqeve në shfrytëzim, të cilin e cakton Kryetari i Komunës përmes Këshillit të Drejtorëve".

Neni 6

Neni 11 ndryshon dhe thuhet:

"Kontrata nga par. 1 i këtij neni, do të nënshkruhet nga përfituesi i së drejtës për shfrytëzimin e qoshkut dhe udhëheqësit të prokurimit publik, ndërsa për rastet sociale nga Kryetari i Komunës".

Neni 7

Neni 12 ndryshon dhe thuhet :

"Vazhdimi i të drejtës për dhënie e qoshkut në shfrytëzimin për rastet e dhënies së drejtpërdrejtë, do të bëhet nga udhëheqësi i njësisë së prokurimit, ndërsa për rastet sociale nga Kryetari i Komunës".

Neni 8

Në nenin 14, pas fjalëve: *statusi i familjes së invalidit*, shtohet edhe:

"Ka pasur apo jo qoshk në komunën e Prishtinës".

Neni 9

Në nenin 15, pas fjalëve: *invalid i punës*, shtohet edhe shkronja *d*:

"Personat me aftësi të kufizuar 2 pikë".

III. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 10

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit të tij.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 353-1771, më 26.11.2008

KRYETARI I KOMUNËS
Prof.dr. Isa Mustafa